

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rasti që ngjali diskutime - Polemika në Spanjë, Mbappé dhe Vinicius mbulojnë fanellën në mbështetje të Ceutës
ADRESA	https://www.syri.net/sport/917144/polemika-ne-spanje-mbappe-dhe-vinicius-mbulojne-fanell-en-ne-mbeshtetje-te-ceutes/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA

KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 18:47:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 15:46:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c019d6bce15174be26097eeded497050c93ce69fd2b6df286b18a93b580d4ea1
TEKSTI	d0206bfd01516ea98c5d40fc0f9b603fcf0fc22d18632a4261ed8f2f1765beca
PAMJA	e81827b70ca0067276e2b1019f43b030af1bb638a93abc59a39160e3ca38c972

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7b9478c68d97268f7fc5ddae39e40243c0933914d7f27c5b63bde6297ff4b05
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9a2ff65fb1ec0abbd824a4690f8572392275823afe6c37713ebc7a42874eb87f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, në **radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7b9478c68d97268f7fc5ddae39e40243c0933914d7f27c5b63bde62978ff4b05>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ÇIM PEKA
Tradhtia që s'e panë tu ardhë



NDRIÇIM KULLA
Gjuha si brushë dhe ironia si armë e Edi Ramës



Polemika në Spanjë, Mbappé dhe Vinicius mbulojnë fanellën në mbështetje të Ceutës

17:46, 16/09/2026

Para ndeshjes Elche-Real Madrid, e cila përfundoi 3-2 në favor të "Los Blancos", Mbappé, Vinicius dhe Konatë u bënë protagonistë të një episodi që ka shkaktuar polemika në Spanjë.

Në momentin e daljes në fushë, të dyja skuadrat kishin veshur një fanellë me një mesazh mbështetjeje për Ceutën, enklavën spanjolle të vendosur në kontinentin afrikan, e cila u përball me një krizë migratore në fund të korrikut.

Megjithatë, dy yjet e Real Madridit, Kylian Mbappé dhe Vinicius Junior, e ngritën fanellën deri në pjesën e krahorit, duke mbuluar mesazhin "Todos somos caballas" ("Të gjithë jemi banorë të Ceutës"), ndërsa mbrojtësi francez Konatë e mbajti fanellën në dorë. Gjesti nuk kaloi pa u vënë re dhe shkaktoi kritika ndaj tre futbollistëve.

Fanellat e veshura nga skuadrat erdhën si pjesë e një nisme të Shoqatës së Sipërmarrësve Valencianë (AVE), e drejtuar nga Vicente Boluda, i cili ka qenë edhe president i përkohshëm i Real Madridit në vitin 2009, mes mandateve të Ramón Calderón dhe Florentino Pérez.

Jo të gjitha klubet e LaLiga-s iu bashkuan kësaj nisme. Mediat spanjolle vënë në dukje se Barcelona zgjodhi të mos merrte pjesë në këtë homazh gjatë transfertave të fundit ndaj Elches dhe Levantes.

Kjo nuk është hera e parë që kjo nismë shkaktonte polemika në Spanjë. Futbollisti i Real Betisit, Ez Abde, i cili luan për kombëtaren e Marokut, u bë objekt i ofendimeve dhe kërcënimeve në rrjetet sociale pasi mori pjesë në të.

"Bëhej fjalë për një fanellë me një mesazh social, në mbështetje të një popullsie dhe banorëve të saj, pavarësisht kombësisë, të cilët po kalonin një situatë të vështirë", u shpreh Abde në mbrojtje të tij pas polemikave.

Pozicioni i Real Madridit

Real Madridi është përpjekur ta minimizojë gjestin e Mbappé-së, Vinicius-it dhe Konatë-së. Sipas klubit, secili është i lirë të veshë fanellën që dëshiron.

Në një deklaratë për 'Mundo Deportivo', klubi theksoi se, ndryshe nga sa ka ndodhur në skuadra të tjera, fanella në mbështetje të Ceutës u vesh nga shumica e lojtarëve të Real Madridit.

"Nuk mund të detyrohet askush të veshë një fanellë, ashtu siç nuk mund të

më të lexuarat

Paraqitjet e legjionarëve/ Cristian Shpendi shkëlqen me dopietë, shënojnë Asani dhe Tuci

Hansi Flick kërkon historinë me Barcelonën, rekordi i madh është vetëm 2 fitore larg

Skandal trukimi në futboll/ Kërcënohet portieri: Lër tre gola, ose do të vrasim familjarët!

Messi do t'i japë lamtumirën Argentinës në ndeshjen e 6 tetorit kundër Beninit

'Jam i demoralizuar', Hamilton pëson goditjen e madhe me Ferrarin në Madrid

Zhegrova shënoi dy gola në Sassuolo-Juventus: E prisja prej kohësh

detyrohet të mos e veshë", kanë theksuar burime pranë klubit madrilen, duke e cilësuar këtë çështje si të parëndësishme.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Atletico Madrid, marrëveshje të fshehtë me Julian Alvarezin për largimin e tij



Ancelotti ndryshon listën e Brazilit, Martinelli merr ftesën e parë



Amorim surprizon me formacionin, Modric, Rabiot e Pulisic në stol ndaj Benfikës

Bëje LIKE dhe merr lajmin e fundit nga Sporti:

Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

Ameruan shfaqin magjeps në Zvicër, nota
thuaje perfekte pas spektaklit me dy
gola

Komiteti Ekzekutiv i UEFA-s përcakton
stadiumet pritëse për finalët e ardhshme
të kompeticioneve europiane

Taulant Seferi nuk ndalet! Dopotë dhe
notë fantastike, sulmuesi kuqezi në
formacionin e javës në Turqi

TË NGJASHME



Luis de la Fuente rinovon me
Spanjën, kontrata deri në vitin 2032



Dhimbje e madhe për Ronald
Koemanin, ndahet nga jeta
bashkëshortja e tij pas betejës me
kancerin



Barcelona do të rrisë kapacitetin e
'Spotify Camp Nou' në 70-72 mijë
tifoze



Kategoria e Parë/ Besa bind, fitojnë
edhe Pogradeci, Kastrioti e Sopoti



Jeton Beqiri nis aventurën në
Azerbajxhan, prezantohet si trajneri i
Gabala-s



Spalletti kërkon reagim nga Juventusit:
Conte? Nuk më habisin këto zëra



Formula 1 zyrtarizon kalendarin e
2027-ës, rikthehen dy pista dhe
shtohen Sprintet

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTE KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIË ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.